

Njoftim për pjesëmarrjen në konkurimin publik për qeradhënien e sipërfaqes (shesh) prej 5885 m², në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

Në zbatim të VKM nr. 529 datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kritereve , të Procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Autoriteti Portual Durrës, shpall konkurimin për dhënien me qera të sipërfaqes prej 5885 m² në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

Të dhëna për objektin dhe përdorimin

Përshkrimi i sheshit : Sheshi është i rrethuar në të gjithë perimetrin me mur me lartësi 2.5 m, i përbërë nga blloqe betoni, kollona beton arme(20 x30 cm) cdo 3 m dhe brez lidhës beton arme. Sheshi është i shtruar me cakull dhe ka rrjetin inxhinierik nëntokesor të shkarkimit të ujrave.

Vendndodhja: Kjo zonë kufizohet në verilindje dhe lindje me parkim doganor TIR në përëndim dhe jug në pjesën tjetër të zonës së ish kantierit detar sipas planimetrisë bashkëngjitur.

Sipërfaqja : Sipërfaqja totale e këtij ambienti është 5885 m²

Afati i qeradhënies është 2 vjet.

Veprimtaria që ushtrohet në objekt: Magazinimi i mallrave të ndryshme, të destinuara për transport detar nëpërmjet Portit të Durrësit.

Destinacioni i përdorimit parashikon krijimin dhe administrimin e kësaj sipërfaqe në regjimin e magazinës së hapur doganore.

Cmimi dysheme i qerasë

Vlera dysheme e qerasë është **4 lek/ m²/ditë**.

Kriteret e vlerësimit:

Vlera e qerasë 100 pikë.

Afati i dorëzimit të ofertave në datën 06.12.2011, ora 10:00 në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual Durrës.

Ofertat do të hapen më datë 06.12.2011 ora 10:00 në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual në prani të komisionit të shqyrtimit të ofertave dhe subjekteve konkurruese.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë subjektet konkurruese:

- a) Kerkesën e subjektit për marrjen me qera të objektit ;
- b) Planbiznesin, ku te jepet me hollesi vënia në funksionim e objektit dhe të përshkruhen qartë nevoja ekonomike e shoqërisë për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor, mallrat që do të vendosen nën këtë regjim gjatë kohëzgjatjes së kontratës, llojet, sasi të e mallrave sipas parashikimeve si dhe treguesit që do të realizohen;
- c) Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- c) Çertifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- dh) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me veprimtarinë;
- e) Sigurim oferte në vlerën e qirase së një muaji, të shpallur në njoftimin për konkurrim;

Për informacione të mëtejshme, Ju lutemi të kontaktoni në Drejtorinë Egzekutive të Autoritetit Portual, Nr tel/ fax 052 223115 dhe faqen e internetit www.apdurrës.com.al

Ing. Eduard **NDREU**

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

